

Nga: KALLXO.com

Për: Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës

Lënda: Përgjigje në ankesën e drejtorit të RTK-së, Shkumbin Ahmetxhekaj dhe Arsim Halilaj

Datë: 15 shtator 2022, Prishtinë

Të nderuar anëtar të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës,

Me datën 2 shtator 2022 kemi pranuar ankesën e drejtorit të përgjithshëm të Radio Televizionit të Kosovës, Shkumbin Ahmentxhekaj, kundër artikullit të publikuar në KALLXO.com.

Duke e vlerësuar ankesën si joprofessionale të pabazuar me pretendime të falsifikuara të cilat synojnë ta vejnë në lajthitje KMSHK-në dhe të ushtrojnë presion ndaj raportimeve të sakta të mediave kërkojmë që kjo ankesë të refuzohet.

KALLXO.com, gjatë viteve të fundit ka mbajtur qindra trajnime me studentë të gazetarisë e drejtësisë, zyrtarë të nivelit lokal e qendror, rreth të drejtës mediale, duke nxituar dhe inkurajuar për shfrytëzimin e mekanizmave vetërregullues siç janë KMSHK për të mbrojtur imazhin nga raportimet e pa drejta dhe të pasakta. Po ashtu, ka përkrahur projekte që nxisin studentët që të parashtrojnë ankesa në KMSHK dhe monitorojnë mediat e shkruara, mirëpo kjo ankesë e tillë e llojit SLAPP<sup>1</sup>, e ushtruar nga një drejtor televizioni i cili do duhej t'i dijë me saktësi parimet gazetareske dhe ligjore (kjo edhe pasi ka shumë juristë në punë në mediumin ku punon) nuk ka asnjë synim tjetër përpos t'i frikësojë mediat në raportimet e tyre profesionale mbi zhvillimet e një procesi hetimor të hapur ndaj tij në Prokurorinë Speciale, përmes tentimit për t'i vënë në lajthitje anëtarët e Bordit të KMSHK-së dhe mbi të gjitha opinionin publik.

Ankuesi pretendon se me rastin e publikimit të këtij artikulli, Kallxo.com ka bërë shkelje të Kodit Etik të Mediave të Shkruara, përkatësisht Kreut II - Raportimi i së vërtetës dhe Kreut IV - E drejta për t'u përgjigjur.

<sup>1</sup> Ankesat SLAPP nënkuptojnë "Strategic Lawsuits Against Public Participation" që nënkuptojnë që janë iniciativa ligjore që janë të menduara t'i frikësojnë një grup njerëzish, aktivistësh, gazetarë për të mos u marrë me temën e caktuar të cilën paditësi dëshiron ta lë të heshtur apo të fshehur.

Kallxo.com argumenton se ankesa e drejtorit të RTK-së është krejtësisht e pabazuar dhe artikulli i publikuar në KALLXO.com, si çdo artikull tjetër, i ka respektuar të gjitha pikat e Kodit Etik të Mediave të Shkruara dhe për arsyet në vijim kërkojmë që ankesa në fjalë të REFUZOHET.

## ARSYETIM

Në ankesën e tyre precedentët kanë falsifikuar titullin origjinal të publikuar nga KALLXO.com duke synuar t'i vejnë në lajthitje KMSHK-në me informacione të paqena mbi përmbajtjen e titullit.

Ankuesi pretendon se KALLXO.com ka publikuar artikullin me titullin *“Prokuroria Speciale ka nisur hetim ndaj drejtorit të Përgjithshëm, Shkumbin Ahmetxhekaj dhe UD zëvendës drejtorit, Arsim Halili ndërkohë që deri ke ky konstatim ka ardhur pa ndonjë qëndrim zyrtar të prokurorisë”*

KALLXO.com konstaton se në këtë pikë ankuesit kanë tentuar të falsifikojnë titullin dhe t'i vejnë në lajthitje anëtarët e KMSHK-së për shkak se titulli i publikuar nga kallxo nuk ka këtë përmbajtje.

Titulli i vërtetë, i bashkangjitur edhe në provat e ankesës, thotë: *“Agjencia Kundër Korrupsion: Rasti i drejtorit dhe zv/drejtorit të RTK-së është përcjellë në Prokurorinë Speciale”*.

Duke mos e kontestuar faktin që në këtë rast ka mjaft argumente që një hetim është duke ndodhur, raportimi ynë ka qenë skajshmërisht profesional pasi titulli transmeton lajmin që rasti është përcjellë në Prokurorinë Speciale pa e vendosur fokusin që atje është duke ndodhur edhe një hetim.

Tendenca për t'i atribuar kallxo.com një titull i cili nuk është publikuar nga kallxo.com është joprofionale për të mos thënë e qëllimshme.

Duke mos mu marrë me titullin tonë dhe përmbajtjen tonë të cilat nuk e përmendin hetimin në titull po ju argumentojmë që edhe titujt tjerë të renditur nga mediat e tjera nuk kanë problem nëse kanë raportuar se në këtë rast janë nisur hetime.

Ankuesit synojnë që nëpërmjet dokumentit që nuk janë nën hetime të argumentojnë që Prokuroria Speciale nuk ka rast të hapur ndaj tyre.

Fakti që ankuesi ka paraqitur si dëshmi vërtetimin që nuk është subjekt hetimi, nuk nënkupton se ndaj të njëjtit nuk ndërmerren veprime hetimore. Çertifikata që një person nuk është nën hetime evidenton vetëm personat ndaj të cilëve është nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve.

Trajtuesit e ankesës duhet të jenë në dijeni se konform kodit penal procedura hetimore mund të nisë edhe pa aktvendim për fillimin e hetimeve. Neni 69 dhe neni 70 i Kodit të Procedurës Penale përcaktojnë në mënyrë të qartë se një person mund të hetohet paraprakisht pa pasur aktvendim për fillimin e hetimeve. Këto dy nene paraqesin fazën fillestare të hetimeve policore përpara ngritjes së kallëzimit penal apo fillimit zyrtar të hetimeve.

Raportimi në këtë rast flet për fazën paraprake kur me autorizim të prokurorit policët nisin hetimin e një rasti. Dokumenti i AKK-së qartë flet për një autorizim të lëshuar nga Prokuroria Speciale për policinë për të mbledhur informacione

Fakti që pretenduesit synojnë që nëpërmjet certifikatës që nuk janë nën hetime të kontestojnë mungesën e një urdhri të tillë dëshmon tendencën që antarët e KMSHK-së të vendosen në lajthitje të fakteve. Vetëm një leximi i thjeshtë i kodit të procedurës penale mundëson të confirmohet fakti se një person mund të jetë i hetuar edhe nëse nuk ka aktvendim për fillim të hetimeve.

### Pretendimet për shkelje të Kreut II - Raportimi i së vërtetës:

Ankuesi pretendon se "KALLXO.com ka dezinformuar pasi ka konstatuar se Prokuroria Speciale ka nisur hetim ndaj drejtorit tij dhe zëvendësdrejtorit, Arsim Halili dhe se deri tek ky konstatim ka ardhur pa ndonjë qëndrim zyrtar të prokurorisë.

Sipas ankuesit lajmi i publikuar është i bazuar në një dokument të Agjencisë Kundër Korrupsionit ku qartë thuhet se AKK e ka mbyllur rastin e hetimit paraprak, duke u thirrur në nenin 18, paragrafi 10 i Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Tutje ankuesi pretendon se shkrimi i portalit kallxo.com, thirret në një confirmim nga AKK se rasti është përcjelle në Prokurori, e që si konstatim ka për bazë paragrafin 6 të këtij ligji përkundër se agjencia në dokument nuk është thirrur në këtë nen, por në nenin 10. Për të vërtetuar që nuk është nën hetime, drejtori i përgjithshëm i RTK-së ka bashkangjitur edhe vërtetimin zyrtar që ndaj tij nuk po zhvillohet procedurë hetimore".

PËRGJIGJIE: Pretendimi i ankuesit se KALLXO.com nuk e ka raportuar të vërtetën nuk qëndron:

1. Në rastin konkret Agjencia Kundër Korrupsion nuk e ka mbyllur hetimin paraprak për faktin se nuk ka pasur prova por të njëjtin e ka mbyllur për faktin se rasti veçse ka qenë duhet u trajtuar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe në këtë rast Agjencia Kundër Korrupsion nuk mund të kryejë hetim paralel me Prokurorinë Speciale, andaj si rezultat ka vendosur që të mbyllë hetimin, dhe dosjen e ka bartur në këtë prokurori për hetim të mëtejme.

PROVË: Njoftimi i AKK-së i datës  
13 korrik 2022 për mbylljen e hetimit

Pra, siç përshkruhet në arsyetimin e njoftimit, mbyllja e rastit nuk është bërë për arsye se nuk ka pasur bazë për hetim nga AKK, por është bërë për faktin se rasti ka qenë duke u trajtuar nga Njësia e Veçantë e Hetimeve sipas autorizimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

“AKK e mbyllë rastin e hetimit paraparak në pajtim me dispozitën e nenit 18(par 10) të Ligjit për AKK-në, sepse rasti është duke u trajtuar nga Njësia e Veçantë e Hetimeve/Departamenti i Hetimeve, në Policinë e Kosovës sipas autorizimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës”, thuhet në këtë njoftim.

Pra, është i pavërtetë pretendimi i ankuesit se rasti është mbyllur mbi faktin se nuk ka dyshim të bazuar për vepër penale ose shkelje administrative, sepse në mënyrë taksative AKK thotë se mbyllja bëhet pasi ka hetim nga prokuroria speciale.

Po ashtu ju sjellim në vëmendje se në çdo rast të tillë kur ka hetim paralel të Agjencisë Kundër Korrupsion dhe Prokurorisë së shtetit, rastet në AKK bëhen të padrejtueshme për faktin se nuk ka objekt trajtimi pasi, nisja e hetimit në Prokurori konsiderohet që e bën automatikisht të padrejtueshëm rastin edhe në Agjencinë Kundër Korrupsion.

Është praktikë notore dhe procedurale që në rastet kur hetimet janë duke u drejtuar nga Prokuroria e Shtetit agjencitë e tjera i subordinohen autoritetit të prokurorisë.

Andaj në raste të tilla nuk do të thotë që ndaj këtyre personave nuk ka ndonjë hetim paraparak.

Për ta vërtetuar këtë po ua bashkëngjisim edhe përgjigjen e prokurorisë speciale pas publikimit të artikullit në të cilën përshkruhet se Prokuroria është duke mbledhur provat e nevojshme për ta vlerësuar rastin.

Provë: Përgjigja e Prokurorisë  
e datës 21 korrik 2022

Po ashtu nëse e analizoni artikullin e publikuar në KALLXO.com do të shihni se në asnjë moment artikulli nuk ka pretenduar se ka aktvendim për fillim të hetimeve ndaj drejtorit Shkumbin Ahmetxhekaj, mirëpo vetëm përshkruhet se rasti është mbyllur dhe bartur në organet ndjekëse, siç përshkruhet edhe në njoftimin e AKK-së.<sup>2</sup>

## **NJOFTOHENI se:**

AKK e mbyll rastin e hetimit paraprak në pajtim me dispozitën e nenit 18 (paragrafi 10) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, sepse rasti është duke u trajtuar nga Njësia e Veçantë e Hetimeve/Departamenti i Hetimeve, në Policinë e Kosovës sipas autorizimit nga Prokuroria Speciale, AKK, dokumentacion e siguruar, e ka përciellur përmes postës me datë 08.07.2022. në këtë Njësi.

PROVË: Njoftimi i AKK-së i datës  
13 korrik 2022 për mbylljen e hetimit

Andaj, për këto arsye konsiderojmë se në këtë rast nuk ka një të vërtetë të dytë mirëpo e vërteta e plotë është ajo cka është raportuar që ndaj personave ka një dosje në prokurorinë speciale, që policia është duke hetuar dhe që Agjencioni Kundër Korrupsionit e ka bartur lëndën në Prokurori speciale ku ajo po hetohet.

Andaj pretendimi i ankuesve se është raportuar e pavërteta nuk qëndron dhe njëjti duhet të refuzohet.

- Pretendimet për shkelje të Kreut IV - E drejta për t'u përgjigjur.

Në pikën dy të ankesës, ankuesi pretendon se KALLXO.com nuk e ka respektuar të drejtën për tu përgjigjur. Në këtë rast sjellim në vëmendjen tuaj se kemi të bëjmë me një komunikatë për media të dërguar nga sindikata e RTK-së. Edhe përkundër faktit që në këtë rast kemi të bëjmë me një komunikatë e cila përmbanë në vehte një dokument autentik të një mekanizmi ligjor siç është Sindikata e Pavarur e RTK-së dhe se në këtë rast publikuesi i informacionit kufizohet në raportim të drejtë dhe të saktë, KALLXO.com i ka telefonuar Shkumbin Ahmetxhekajt për të marrë një koment e më pas edhe i ka dërguar email. Telefonata dhe emaili kanë ndodhur 4 orë pasi është lëshuar komunikata e Sindikatës dhe ankuesit i është dhënë kohë për tu përgjigjur.

<sup>2</sup> <https://kallxo.com/lajm/agjencia-kunder-korrupsion-rasti-i-drejtorit-dhe-zv-drejtorit-te-rtk-se-eshte-percielle-ne-prokurorine-speciale/>

Përkundër kësaj ankuesi deri më sot nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për tu përgjigjur në këtë artikull dhe kjo është evidentuar edhe në shkrimin e kontestuar.

Andaj konsiderojmë që KALLXO.com e ka përmbushur këtë obligim dhe edhe në këtë rast, sipas kodit të KMSHK-së, e drejta për tu përgjigjur nuk është shkelur.

Por, për hirë të argumentit shtesë, edhe pse Kallxo e ka kontaktuar Z. Ahmetxhekaj për përgjigje, edhe poqëse nuk do e kishim kontaktuar (siç ndodh rasti me media tjera) duhet të ceket që për raste të raportimeve të tilla si kjo e drejta për tu përgjigjur nuk kërkohet sipas rregullativës së KMSHK-së.

Rregullimi i kreut IV të kodit të etikës i përcakton saktë momentet kur gazetarët duhet të kërkojnë domosdoshmërisht përgjigjen nga palët.

Kodi i etikës parasheh: *“Është obligim i gazetarëve, redaktorëve dhe i gazetave, portaleve e agjensive të lajmeve që të botojnë reagime dhe/ose demante kur mediat publikojnë informata të pasakta për një individ apo organizatë”*

Arsyetim Në këtë rast nuk ka asnjë raportim të pasaktë pasi raportimi është i bazuar në dokumentin autentik të lëshuar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit. Pra artikujt ndaj të cilëve po ankohet Z. Ahmetxhekaj nuk janë trillime por janë artikuj që bëjnë raportimin e saktë siç edhe mund ta lexoni në dokumentin e AKK-së.

Kodi i etikës parasheh: *“E drejta për t’u përgjigjur do t’u mundësohet personave përkatës nëse botimi në fjalë përcakton që duhet të ndërmerret një hap të tillë për qëllime të korrektësisë dhe paanshmërisë. Duhet të ekzistojë mundësi për publikim të menjëhershëm të reagimit/përgjigjes në median e njëjtë”.*

Arsyetim: Agjencioni Kundër korrupsionit është insitucion shtetëror dokumentet e të cilat janë dokumente të cilat transmetojnë një vendimarrje të një institucionit publik. Raportimi për dokumente të tilla nuk kërkon medoemos kontaktimin e anës tjetër për shkak se vendimarrja ka ardhur pas një raporti hetimor dhe procesi vendimarrës. Veprimet e AKK-së në këtë rast janë procedurale dhe komentimi tyre nuk ndryshon gjendjen në terren.

Kodi i Etikës parasheh: *Gjatë raportimit dhe komentimit të një ngjarjeje kontraverse, gazetatat, portalet dhe agjensitë e lajmeve do të përpiqen t’i dëgjojnë dhe t’i përfaqësojnë të gjitha palët në kontest. Nëse njëra palë brenda kontraversës refuzon të jetë në dispozicion për gazetarin, publikimi do të duhej ta theksojë këtë refuzim gjatë raportimit të vet.*

Arsyetim: Në këtë rast nuk ka pasur asgjë kontraverse. Raportimi ka transmetuar veprimin e një insitucioni të ndërmmarrë ndaj një çështjeje hetimore, veprime këto që

përbëjnë lajm për publikun dhe atë lajm me interes të lartë për publikun për shkak të postit të lartë që ushtron Z. Ahmetxhekaj, udhëheq me Televizionin Publik.

Si rrjedhojë raportimet janë në përputhe të plotë me Kodin Etik dhe praktiken e Këshillit të Mediave të Shkruara, pasi rasti konkret është analogji e shkrimeve/artikujve të cilët rrjedhin nga vendimet gjyqësore apo vendimet e organeve ndjekëse siç kemi raportuar gjithmonë.<sup>3</sup>

Ashtu siç duket, me vet faktin që Ahmetxhekaj ka bërë ankesë ndaj, jo një, por të gjitha mediave që e kanë raportuar komunikatën e Sindikatës së RTK-së<sup>4</sup>, Ahmetxhekaj duket se ka menduar që çështja e hetimeve ndaj tij duhet të mos raportohet fare. Këtu qëndron esenca e ankesës së tij, të ankohet në gjithë mediat që shkruajnë për te, në mënyrë që, në të ardhmen, të frikësohen të gjithë të raportojnë për te gjatë gjithë procesit hetimor, edhe kur AKK, Gjykatat, Prokuroritë e edhe Sindikata ka dokumente që dëshmojnë inkrimimin e tij apo të bashkëpunëtorëve të tij në një hetim.

Mu kjo ankesë që na e bën të gjithëve për raportim ndaj një dokumenti zyrtar që është lëshuar nga AKK dhe që e qet Z. Ahmetxhekaj në dritë jo të mirë, na bën të kuptojmë që këtu kemi të bëjmë me një iniciativë SLAPP që ka për qëllim të shukasë çfarëdo kritikë për te dhe për bashkëpunëtorët e tij. Qëllimi i kësaj iniciative SLAPP është pikërisht çka nënkuptojnë këto iniciale, Iniciativë Strategjike Kundër Participimit të Publikut. Në këtë rast publiku janë platformat që kanë raportuar për faktin që AKK e ka përcjell rastin e Ahmetxhekaj në Prokurorinë Speciale. Me leximin e ankesës që e ka bërë Zoti Ahmetxhekaj kundër nesh ne po kuptojmë që ne qenkemi dashur të mos e publikojmë fare lajmin që drejtori i Televizionit Publik është duke u hetuar në Prokurorinë Speciale, me ç'rast në fakt do e kishim thyer Kodin e Etikës për shkak se i bjen që do kishim vendosur ta 'mbrojmë' një 'koleg gazetar' për t'ia 'ruajtur reputacionin' sepse është 'koleg i joni'.<sup>5</sup>

Andaj mbi bazën e këtyre arsyejeve, konsiderojmë se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë dhe pas analizimit të kësaj përgjigje, kërkojmë nga Këshilli i Mediave të Shkruara që ankesa në fjalë të REFUZOHET si e PA BAZUAR.

Me respekt,

Kreshnik Gashi, Kallxo.com



<sup>3</sup> <https://kallxo.com/lajm/kpk-me-vendim-ne-rastin-disiplinor-ndaj-prokurorit-agron-uka/>

<sup>4</sup> Edhe ndaj atyre që e kanë thirr Ahmetxhekën për të thanë anën e tij në këtë çështje, e edhe atyre që s'e kanë kontaktuar fare.